




		<b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	D.P.K.	Nr. Prot.	03-02/290/1/2
Dep.		Bi. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.	02	Data	
Broj stranica		Datum	29.09.2012
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.09.2017, mori:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-02-2404/16, për z. Arber Muhamxheri, Drejtor i Departamentit për promovimin e sektorit privat në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Arber Muhamxheri, Drejtor i Departamentit për promovimin e sektorit privat, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në bizneset private Sh.p.k "Vava Group" dhe Sh.P.K "Azbut", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Muhamxheri është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (parografi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se do të ndërmerr veprime me qëllim të evitimit të situatës së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Muhaxheri ka sjellë në Agjenci shkresën zyrtare (DPKI.03-02/2685/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të cituara më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollji  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

